

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 6.10.1999, une, gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit zj.XHOANA NANO, e cila kerkoi regjistrimin e shoqerise "JOY TRAVEL" ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar

K O N S T A T O V A :

Se kerkesa e kerkuesit per regjistrimin e shoqerise tregtare te emertuar "JOY TRAVEL" sh.p. k. me Ortak te Vetem zj.XHOANA NANO, me kapital 100 000 leke, administrator z. FATMIR BUSHATI, me seli ne Tirane, Rruga "Miqesia", pall.8, shk.1, ap.5, me kohezgjatje te veprimtarise me afat te pacaktuar mbi 10 vjet, me objekt te veprimtarise :

- Hapje e agjensive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit;
- Veprimtari tregtare ne fushen e turizmit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjensise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut e ne fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e te udhetareve urban, nderurban dhe nderkombetar; eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

V E N D O S A


Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare te emertuar "JOY TRAVEL" ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me Ortak te Vetem zj.XHOANA NANO, me kapital 100 000 leke, administrator z. Fatmir Bushati, me seli ne Tirane, ne rrugen "Miqesia", pall.8.shk.1, ap.5, me kohezgjatje te veprimtarise me afat te pacaktuar mbi 10 vjet, me objekt te veprimtarise :

- Hapja e agjensive turistike;

- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit;
- Veprimtari tregetare ne fushen e turizmit,hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjensise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve,marketingut e ne fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e te udhetareve urban, nderurban dhe nderkombetar.

Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Altin Xheza", written over a large, stylized, handwritten letter "A".

22069/1

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 22.069/1

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 20. 01. 2000, une, gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1, date 14.01.2000 te Ortakut te Vetem te shoqerise "JOY TRAVEL"sh.p.k.

K O N S T A T O V A :

Se me vendim te gjykates se rrethit Tirane nr. 22069, date 06.10.1999 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "JOY TRAVEL"sh.p.k. me ortak te vetem zj. Xhoana Nano, me kapital themeltar 100'000 leke.

Me vendim nr.1, date 14.01.2000 te Ortakut te Vetem te shoqerise eshte vendosur

6. Ortaku i vetem i shoqerise, zj.Xhoana Nano transferon pjeserisht kuota te kapitalit qe zoteron, si me poshte :

Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

7. Futjen ne shoqeri te ortakeve te rinj duke aritur ne kete menyre pjesmarja ne kapital :

Xhoana Noano	70 %	ose	70'000 leke
Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	100'000 leke

8. Per aresye te kalimit te shoqerise nga ortak i vetem me disa ortake miratohen edhe disa ndryshime ne statutin e shoqerise

9. Emri, selia, kohezgjatja, kapitali, administratori dhe vula e shoqerise nuk kane ndryshim.

10. Ngarkohet zj.Xhoana Nano te kryeje veprimet per depozitimin e ketij vendimi prane regjistrin tregtar.

Ne keto kushte, ai kerkon depozitimin prane regjistrin tregtar ketij vendimi. Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin tregetar te vendimit nr.1, date 06.10.1999 te Ortakut te Vetem te shoqerise "JOY TRAVEL" sh.p.k.

1. Ortaku i vetem i shoqerise, zj.Xhoana Nano transferon pjeserisht kuota te kapitalit qe zoteron, si me poshte :

Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

2. Futjen ne shoqeri te ortakeve te rinj duke aritur ne kete menyre pjesmarja ne kapital :

Xhoana Noano	70 %	ose	70'000 leke
Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	100'000 leke

3. Per aresye te kalimit te shoqerise nga ortak i vetem me disa ortake miratohen edhe disa ndryshime ne statutin e shoqerise

4. Emri, selia, kohezgjatja, kapitali, administratori dhe vula e shoqerise nuk kane ndryshim.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar ne kollonet 4 dhe 5

GJYQTARE

Mayana Bechi
Mercaj

REPubLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 22069/2

22069/2

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 30.01.2001, une, gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1, date 15.11.2000 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "JOY TRAVEL"sh.p.k.

K O N S T A T O V A :

Se me vendim te gjykates se rrethit Tirane nr. 22069, date 06.10.1999 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "JOY TRAVEL"sh.p.k. me ortak te vetem zj. Xhoana Nano, me kapital themeltar 100'000 leke.

Me vendim nr.1, date 14.01.2000 te Ortakut te Vetem te shoqerise eshte vendosur

1. Ortaku i vetem i shoqerise, zj.Xhoana Nano transferon pjeserisht kuota te kapitalit qe kotoneron, si me poshte :

Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

2. Futjen ne shoqeri te ortakeve te rinj duke aritur ne kete menyre pjesmarja ne kapital :

Xhoana Nano	70 %	ose	70'000 leke
Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	100'000 leke

3. Per aresye te kalimit te shoqerise nga ortak i vetem me disa ortake miratohen edhe disa ndryshime ne statutin e shoqerise

4. Emri, selia, kohezgjatja, kapitali, administratori dhe vula e shoqerise nuk kane ndryshim.

5. Ngarkohet zj.Xhoana Nano te kryeje veprimet per depozitimin e ketij vendimi prane regjistrin tregetar.

Me vendim nr. 1, date 15.11.2000 Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka vendosur :

1. Disa prej Ortakeve te shoqerise transferojne tek zj.Xhoana Nano teresisht kuotat e kapitalit qe zoterojne si me poshte :

Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

2. Largimin nga shoqeria te ortakeve te siperpermendur duke aritur ne kete menyre pjesmarja ne kapital :

Xhoana Nano	95 %	ose	100'000 leke
Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke

3. Emri, selia, kohezgjatja, kapitali dhe vula e shoqerise nuk kane ndryshim.

4. Administrator i shoqerise eshte zj. Xhoana Nano.

5. Ngarkohet zj.Xhoana Nano te kryeje veprimet per depozitimin e ketij vendimi prane regjistrin tregetar.

Ne keto kushte, kerkuesja kerkon depozitimin prane regjistrin tregetar per ketij vendimi

Kerkesa e jete e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin tregetar te vendimit nr.1, date 15.11.2000 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "JOY TRAVEL"sh.p.k.

1. Disa prej Ortakeve te shoqerise transferojne tek zj.Xhoana Nano teresisht kuotat e kapitalit qe zoterojne si me poshte :

Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

2. Largimin nga shoqeria te ortakeve te siperpermendur duke aritur ne kete menyre pjesmarja ne kapital :


Xhoana Nano 95 % ose 95'000 leke

Besim Kaca 5 % ose 5'000 leke

3. Emri, selia, kohezgjitja, kapitali dhe vula e shoqerise nuk kane ndryshim.

4. Administrator i shoqerise eshte zj. Xhoana Nano.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar ne kollonen 4 dhe 5 .

GJYQTARE
Enila Cepo


22069/3

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 22069/3 AKTI

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 14.07. 2002, Une, *Shkurtaj* gjyqtare e vetme e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Z. Eduart Helmasi, me cilesine e Administratorit te shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. per depozitim e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie, date 16 Korrik 2002 prane Zyres se Regjistrimit Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Joy Travel" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 22069, date 6 Tetor 1999. Shoqeria ka bere disa ndryshime me Vendim te Gjyqtarit te Vetem dhe konkretisht me Vendimet nr. 22069/1, date 20 Janar 2000 dhe 22069/2, date 30 Janar 2001.

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- Hapjen e agjencive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit, Veprimtari tregtare ne fushen e turizmit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjencise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut dhe fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e udhetareve urban, interurban dhe nderkombetar.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rruga "Miqesia", Pall. 8, Shk. 1, Ap. 5.

Kapitali i shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. eshte 100.000 leke dhe ortakët e shoqerise jane si me poshte:

- Znj. Xhoana Nano, e cila zoteron 95% te kapitalit te shoqerise ose 95 pjese kapitali me vlere prej 95.000 Leke..
- Besim Kaca, i cili zoteron 5 % te kapitalit te shoqerise ose 5 pjese kapitali me vlere prej 5.000 Leke.

Me date 16 Korrik 2002, me vendim te Asamblese se Ortakeve, ortakët e kesaj shoqerie kane vendosur:

1. Pranimin e kerkeses se Administratorit te shoqerise per doreheqjen e tij nga ky post.
2. Emerimin e Administratorit te ri te shoqerise i cili eshte Z. Eduart Helmasi, shtetas shqiptar, i biri i Petros, lindur me 9 Gusht 1964, banues ne Rrugen "Reshit Collaku", Pall. 2, Ap. 10, Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. 1005801.

3. Pranimin e ndryshimit te selise se shoqerise ne adresen Tirane, ambientet brenda Stadiumit "Selman Stermasi".

Qe nga ky moment Administrator i shoqerise eshte Z. Eduart Helmasi, shtetas shqiptar, i biri i Petros, lindur me 9 Gusht 1964, banues ne Rrugen "Reshit Collaku", Pall. 2, Ap. 10, Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. 1005801.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, ne ambientet brenda Stadiumit "Selman Stermasi".

Une gjyqtarja, pasi shqyrtova kerkesen e tyre dhe cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",


V E N D O S A

Depozitimimin ne Regjistrin Tregtar te:

- Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "Joy Travel" SH.P.K., date 16 Korrik 2002.
- Kerkeses drejtuar Gjykates se Rrethit Tirane

Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor ne kollonen duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me 14.04. 2002

GJYQTARE


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr..... AKTI 22069/4

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 08-11- 2002, Une, *M. Daj* gjyqtare e vetme e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Z. Eduart Helmasi, me cilesine e Administratorit te shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. per depozitimin e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerise, date 8-10-2002 prane Zyres se Regjistrimit Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Joy Travel" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 22069, date 6 Tetor 1999. Shoqeria ka bere disa ndryshime me Vendim te Gjyqtarit te Vetem dhe konkretisht me Vendimet nr. 22069/1, 22069/2, dhe 22069/3.

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- Hapjen e agjencive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit, Veprimtari tregtare ne fushen e turizimit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjencise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut dhe fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e udhetareve urban, interurban dhe nderkombetar.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, ne ambientet brenda stadiumit "Selman Stermasi".

Kapitali i shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. eshte 100.000 leke dhe ortaket e shoqerise jane si me poshte:

- Znj. Xhoana Nano, e cila zoteron 95% te kapitalit te shoqerise ose 95 pjese kapitali me vlere prej 95.000 Leke..
- Besim Kaca, i cili zoteron 5 % te kapitalit te shoqerise ose 5 pjese kapitali me vlere prej 5.000 Leke.

Me date 28.10.2002, me vendim te Asamblese se Ortakeve, ortaket e kesaj shoqerise kane vendosur:

Shtimin e objektit te shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. dhe paraqitjen e ndryshimeve perkatese ne statutin e shoqerise si me poshte:

"Per ushtrimin e aktivitetit te saj, Shoqeria do te hape edhe nje rrjet lokalesh, bar-kafe, fast-foode-sh apo te tjera si keto te cilat nuk jane permendur shprehimisht por perfshihen ne kategorine e lokaleve. Ato do te vendosen ne ambientet e pikave te nisjes se autobuzeve me qellim ofrimin e nje sherbimi cilesor dhe bashkekohor per udhetaret apo dhe per kliente te tjere qe deshirojne qe ti frekuentojne ato".

Une gjyqtarja, pasi shqyrtova kerkesen e tyre dhe cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

VENDOSA

Depozitimim ne Regjistrin Tregtar te:

- Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "Joy Travel" SH.P.K., date 28.10.2002.
- Kerkeses drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor ne kollonen 4 duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me 09-11-2002

GJYQTARE

Mariamp Dede

(M. Dede)

22069/5

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 22069/5 AKTI

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 17 Janar 2003, Une, Bruna Copo gjyqtare e vetme e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Z. Eduart Helmasi, me cilesine e Administratorit te shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. per depozitimn e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie, date 14 Janar 2003 prane Zyres se Regjistrit Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Joy Travel" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 22069, date 6 Tetor 1999. Shoqeria ka bere disa ndryshime me Vendim te Gjyqtarit te Vetem dhe konkretisht me Vendimet nr. 22069/1, 22069/2, 22069/3, 22069/4.

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- Hapjen e agjencive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit, Veprimtari tregtare ne fushen e turizimit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjencise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut dhe fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e udhetareve urban, interurban dhe nderkombetar.
- Etj

Kapitali i shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. eshte 100.000 leke dhe ortakët e shoqerise jane si me poshte:

- Znj. Xhoana Nano, e cila zoteron 95% te kapitalit te shoqerise ose 95 pjese kapitali me vlere prej 95.000 Leke..
- Besim Kaca, i cili zoteron 5 % te kapitalit te shoqerise ose 5 pjese kapitali me vlere prej 5.000 Leke.

Me date 06.01.2003, me vendim te Asamblese se Ortakeve, ortakët e kesaj shoqerie kane vendosur:

- 1) Shitjen e pjeseve te kapitalit prej 5% te z. Besim Kaca.
- 2) Blerjen e ketyre pjeseve te kapitalit nga ortaku znj. Xhoana Nano qe do te jete dhe ortaku i vetem i shoqerise duke zoteruar 100% te pjeseve te kapitalit.

- 3) Marrjen persiper nga Z. Besim Kaca per shlyerjen e te gjitha detyrimet tatimore si dhe cdo detyrim tjeter ndaj shoqerise dhe personave te trete qe i takojne atij deri ne momentin e shitjes se pjeseve te kapitalit.

Une gjyqtarja, pasi shqyrtova kerkesen e tyre dhe cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A


Depozitimim ne Regjistrin Tregtar te:

- Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "Joy Travel" SH.P.K., date 06.01.2003.
- Kontrates se shitjes se pjeseve te kapitalit me Nr 139 Rep dhe Nr. 14 Kol date 15.01.2003
- Kerkeses drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor ne kollonen duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me 14.01. 2003

GJYQTARE



22069/6

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. ~~1-069~~ AKTI
22069/6

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 4/5/ 2005, Une, gjyqtare e vetme e Gjykates se Shkalles se Pare/Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Z. Eduart Helmasi, me cilesine e Administratorit te shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. per depozitimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te Vetem te kesaj shoqerie, date 04.04.2005 prane Zyres se Regjistris Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Joy Travel" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 22069, date 6 Tetor 1999. Shoqeria ka bere disa ndryshime me Vendim te Gjyqtarit te Vetem dhe konkretisht me Vendimet nr. 22069/1, 22069/2, 22069/3, 22069/4 dhe 22069/5.

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- Hapjen e agjencive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit, Veprimtari tregtare ne fushen e turizimit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjencise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut dhe fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e udhetareve urban, interurban dhe nderkombetar.
- Etj...

Kapitali i shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. eshte 100.000 leke dhe ortake e vetme e shoqerise eshte Znj. Xhoana Nano, e cila zoteron 100% te kapitalit te shoqerise ose 100 pjese kapitali me vlere prej 100.000 Leke.

Administrator i shoqerise eshte Z. Eduart Helmasi, shtetas shqiptar, i biri i Petros lindur me 9 Gusht 1964, banues ne rrugen "Reshit Collaku", Pall.2, Ap.10, Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. 1005810.

Me date 04.04.2005, me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur:

1. Rritja e kapitalit te shoqerise "JOY TRAVEL" Sh.P.K sipas bilancit te shoqerise.

2. Caktimi i Z. Ahmet Stojna, shtetas shqiptar, banues ne Tirane ne adresen Rruga e Elbasanit, Pallatet e Fratarit 5/5 Tirane me Nr. License 54 Kod Fiskal 3907717 madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, si ekspert per hartimin e raportit mbi ritjen e kapitalit te shoqerise.

Une gjyqtarja, pasi shqyrtova kerkesen e tyre dhe cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A

Depozitimim ne Regjistrin Tregtar te:

- Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te vetem te Shoqerise "Joy Travel" SH.P.K, date 04.04.2005.
- Kerkeses drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor ne kollonen duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me 4/5/ 2005

GJYQTARE

Wajlynda Dogo

Dogo

22069/7

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 22069/AKTI

A

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me date 31.05.2005, Une A. Caco gjyqtare e vetme e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e Kerkuesit Z. Eduart Helmesi, me cilesine e Administratorit te shoqerise "JOY TRAVEL" SH.P.K. per depozitimn e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te Vetem te kesaj shoqerie, date 25.05.2005 prane Zyres se Regjistrit Tregtar. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqeria "Joy Travel" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimn e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 22069, date 6 Tetor 1999. Shoqeria ka bere disa ndryshime me Vendim te Gjyqtarit te Vetem dhe konkretisht me Vendimet nr. 22069/1, 22069/2, 22069/3, 22069/4 dhe 22069/5.

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- Hapjen e agjencive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit, Veprimtari tregtare ne fushen e turizimit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjencise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut dhe fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e udhetareve urban, interurban dhe nderkombetar.
- Etj

Kapitali i shoqerise "Joy Travel" SH.P.K. eshte 100.000 leke dhe ortake e vetme e shoqerise eshte Znj. Xhoana Nano, e cila zoteron 100% te kapitalit te shoqerise ose 100 pjese kapitali me vlere prej 100.000 Leke.

Administrator i shoqerise eshte Z. Eduart Helmasi, shtetas shqiptar, i biri i Petros lindur me 9 Gusht 1964, banues ne rrugen "Reshit Collaku", Pall.2, Ap.10, Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. 1005810.

Me date 25.05.2005, me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te vetem te kesaj shoqerie, ortaku i vetem i saj ka vendosur:

1. Pranimin dhe miratimin e raportit te ekspertit Z. Ahmet Stojna, per rritjen e kapitalit te shoqerise "JOY TRAVEL" shpk me vleren 32.743.430 leke, nga

perfshirja e fitimeve te pashperndara dhe kontributi i ortakut te vetem ne kapitalin e shoqerise ;

2. Qe nga ky moment kapitali i ri i nenshkruar i shoqerise eshte: 32.743.430 leke plus kapitalin fillestare 100.000 leke i barabarte me **32.843.430 Leke (tridhjetedymilion e teteqindedyzetetre mije e katerqindetridhete Leke)**, i ndare ne 32.843,430 kuota me vlere 1.000 leke secila, I zoteruar 100% nga Ortaku I Vetem I shoqerise Znj. Xhoana Nano.
3. Urdherimin e zyres se regjistrir tregetare per te depozituar vendimin e mesiperm te Asamblese se jashtezakonshme te ortakut te vetem te shoqerise duke pasqyruar ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise.

Keshtu kapitali real i regjistruar i shoqerise eshte **32.843.430 Leke** (tridhjetedymilion e teteqindedyzetetre mije e katerqindetridhete Leke), nga ku vlere nominale e nje kuote eshte 1.000 Leke.

Une gjyqtarja, pasi shqyrtova kerkesen e Administratorit te shoqerise per depozitimn e Vendimit te ASamblese se Jashtezakonshme te kesaj shoqerie, date 25.05.2005 cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A

Depozitimn ne Regjistrin Tregtar te:


- Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te Vetem te Shoqerise "Joy Travel" SH.P.K., date 25.05.2005.
- Raportit te ekspertit te Z. Ahmet Stojna, per zmadhimin e kapitalit te shoqerise te "Joy Travel" SH.P.K, date 20.05.2005.
- Kerkeses drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Urdherimin e zyres se Regjistrir Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor _____ ne kollonen _____ duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane me

2005

GJYQTARE



STATUT

I

SHOQERISE TREGETARE "JOY TRAVEL" SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar", me vullnetin e saj te lire zj.Xhoana NANO, e bija e Virgjilit, e dtl.1973,banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall si vijon :

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "JOY TRAVEL" sh.p.k. me themelues zj.XHOANA NANO.

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane,ne Rrugen "Miqesia",pall..8,shk.1,Ap..5. Ajo mund te çele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithe territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise se saj do te jete :



- Hapja e agjensive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit;
- Veprimtari tregetare ne fushen e turizmit,hoteleri,organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjensise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve,marketingut e ne fusha te tjera te ngjashme;
- Transport te mallrave e udhetareve urban,interurban dhe nderkombetar.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke i perbere nga kontribudi i ortakut te vetem themelues. Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marre ky ortak, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem e i nenshkrueshem.

NENI 7

Kapitali i shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejteshme apo te paluejteshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Aktiviteti dhe rezultati i tij konkretizohen ne nxjerjen e bilanceve periodike e vjetore.

NENI 9

Shoqeria eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe mund te shfrytezoje te drejta materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet. Ne Republiken e Shqiperise kjo shoqeri gezon te drejta si çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria vepron ne regjistrin e prones dhe mund te mare persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kapitalit te saj. Ortaku i Vetem themelues mbart rezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

NENI 11

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Ortaku i Vetem
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte.



NENI 12

Ortaku i Vetem i shoqerise "JOY TRAVEL" eshte zj.XHOANA NANO.

Ajo ka te drejte:

- te emeroje e shkarkoje administratorin ose administratoret e shoqerise;
- te marre vendime per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit;
- te marre vendime per ndryshime ne statut;
- te miratoje bilancet vjetore dhe strategjine e veprimtarise se shoqerise;
- te marre vendime per shitje te kuotave te kapitalit si dhe te transferimit te pjeshem apo te plote te tyre.;
- te marre vendime per prishjen e shoqerise.

NENI 13

Administrator i shoqerise "JOY TRAVEL"z.FATMIR BUSHATI, i biri i Enverit, i dtl.1954, banues ne Tirane.

NENI 14

Administratori dhe personi i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjithë fuqine per detyrimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje kufizim. Ata kane mundesine per te kryer te gjithë aktet qe konsiderojne te pershtatshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte, midis te tjerave, te blejne e te kembejne pasurite qe lidhen me shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit, duke siguruar pjesemarjen per qellimet e veprimtarise te parashikuar nga neni 5 i ketij statuti. Ata kryejne çdo lloj veprimi prane te gjithë zyrave shteterore e private qe kane te bejne me garancite dhe veprime ipotekore, te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arketime si dhe veprime te tjera qe i sherbejne aktivitetit. Ne keto raste personi i ngarkuar nga administratori eshte i detyruar te njoftoje e t'i jape llogari atij.

NENI 15

Administratori, sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, puneson persona te cileve u cakton detyrat dhe pagen. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat e punesimit dhe te sigurimit shoqeror ne R.Sh.

NENI 16

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshjet qe nuk parashikohen ne to, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne R.Sh.



Mosmareveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj , nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

NENI 17

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin vitin e pare ne momentin e regjistrimit ne organet tatimore, ndersa vitet e tjera ne Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi. Bilancet periodike miratohen e nenshkruhen nga Administratori, ndersa bilanci vjetor miratohet nga Ortaku i Vetem i shoqerise. Me miratimin e tij Ortaku i vetem vendos per krijimin e fondeve rezerve e te akumulimit, etj.

NENI 18

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve te siperpermendura dhe shlyerjes se detyrimit fiskal i mbesin ne perdorim Ortakut te Vetem te shoqerise. Konvertimi i parase se realizuar do te behet sipas kushteve te bankes kombetare ose bankave te tjera te nivelit te dyte, ndersa transferimi i tyre do te behet sipas ligjeve shqiptare.

NENI 19

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "JOY TRAVEL" sh.p.k., Tirane-Albania".

NENI 20

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe te aktit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne gjykatën e rrethit Tirane.

NENI 21

Shoqeria mund te priset ne cdo kohe per nje nga shkaqet : humbje kapitali, pamundesi veprimi. Ne kete rast Ortaku i Vetem i shoqerise cakton nje ose me shume Likujdatore. Likujdatori dhe administratori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise per derisa t'ju dorezohen personave perkates, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet fiskale e detyrimet ndaj te treteve.

7



NENI 22

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje Ortaku i Vetem si dhe ligjeve te veçanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxiret vete statuti.

NENI 23

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKU

XHOANA NANO

Xhoana Nano

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1784 REP.
NR. 114 KOL.

VERTETIM

Sot me date 24/10/ 1999, para meje noterit publik B. Saraj, me adrese Dr. "Ullas", u paraqit personalisht zj. Xhoana Nano, e bija e Virgjilit, e dtl. 1973, lindur e banuese ne Tirane, madhore e zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te ciles u sigurova nepermjet pasaportes me nr. e cila me deklaroi se sa me siper e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e saj te lire dhe e nenshkruan regullisht para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK

Besa Saraj



[Signature]

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE TREGETARE "JOY TRAVEL" SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar", me vullnetin e tij te lire zj.Xhoana Nano, e bija e Virgjilit, e datelindjes 1973, lindur e banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall si vijon :

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "JOY TRAVEL" sh.p.k. me themelues zj.Xhoana Nano.

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontribudit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane, ne Rrugen "Miqesia", pall.8, shk.1, Ap.5. Ajo mund te çele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise se saj do te jete :

- Hapja e agjensive turistike;
- Veprimtari te ndryshme ne fushen e turizmit;
- Veprimtari tregtare ne fushen e turizmit, hoteleri, organizim dhe kryerje te sherbimeve te agjensise per veprimtari turistike brenda dhe jashte vendit;
- Sherbime te ndryshme ne fushen e studimeve, marketingut e ne fusha te tjera te ngjashme.
- Transport te mallrave e udhetareve, urban, interurban dhe nderkombetar.



NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke i perbere nga kontribudi i ortakut te vetem themelues. Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marre ky ortak, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem e i nenshkrueshem.

NENI 7

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "JOY TRAVEL" sh.p.k., Tirane- Albania.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Ortaku i Vetem
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

NENI 9

Administrator i shoqerise "JOY TRAVEL" sh.p.k. eshte z. Fatmir BUSHATI, i biri i Enverit, idtl. 1954, banues ne Tirane.

NENI 10

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij akti – themelimi e te statutit bashkelidhur aktit.

NENI 11

Ky akt perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKU
XHOANA NANO

Xhoana Nano



KONTRATE SHITBLERJE
(Kuotash kapitali)

Sot me dt. 18.01.2000 (Janar dymije), ditën e martesës para meje noterit publik
Nexhë Tellez, me adrese m-e Durrës, u paraqiten
palet kontraktuese:

zj. Xhoana Nano, e bija e Virgjilit, i dtl.1973, lindur ne Tirane dhe banuese ne
Tirane, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te
ciles u sigurova nepermjet pasaportes me nr. 0810231, me cilesine e shitesit dhe

z. Besim Kaca, i biri i Jahos, i dtl. 1957, lindur ne Peshkopi dhe banues ne Tirane,
Rr. "Niko Avrami", P.19, Shk.3, Ap.23, madhor e me zotesi te plote juridike per te
vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nepermjet leternjoftimit me UG Nr.
011099, me cilesine e bleresit.

z. Astrit Hoxha i biri i Hasanit, i dtl. 1970, lindur e banues ne Xhafezotaj, Durrës,
madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u
sigurova nepermjet pasaportes me nr.0184687, me cilesine e bleresit.

z. Koco Gaba, i biri i Ilias, i dtl.1953, lindur e banues ne Tirane, madhor e me
zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nepermjet
pasaportes me nr. 0265426, me cilesine e bleresit.

z.NESTI DEÇKA, i biri i Petros, i dtl.1955, lindur e banues ne Tirane, Rr.
"Myslym Shyri", pall.6,ap.46, me pasaporte nr. 120070, me cilesine e bleresit.

Shitesi, Xhoana Nano, deklaroi se shet pjeserisht kuotat e veta te kapitalit qe gezon
ne shoqerine "JOY TRAVEL" sh. p. k. prej 100% ose 100 000 (njeqind mije)
leke duke ja transferuar keto bleresve te siperpermendur ne keto % :

Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

Bleresit, Besim Kaca, Astrit Hoxha, Koco Gaba dhe Nesti Decka deklarojne se
blejne kuotat e kapitalit ne perqindjet dhe vleften e mesiperme.

Qe nga ky moment shitesi zhvishet nga cdo e drejte pronesie mbi keto kuota duke ja kaluar keto te drejta bleresve.

Bleresit qe nga ky moment gezojne te drejta te plota pronesie mbi keto kuota kapitali.

Palet deklarojne se i kane shlyer detyrimet.

Kjo kontrate redaktohet ne shtate kopje autentike nga te cilat nje qendron ne zyren e noterise, nje prane zyres se rregjistrimit tregtar, nje ne dokumentat baze te shoqerise dhe nga nje kopje secila pale.

Pasi u lexua nga palet dhe u gjet konform vullnetit te tyre te lire u nenshkrua prej tyre ne pranine time dhe une noteri e vertetoj ne baze te ligjit.

SHITESI

Xhoana Nona Xhona

BLERESIT

*Koco Gaba
Besim Koca
Nesta*

Astrit Hoxita


[Signature]

INOTERI PUBLIK

NEXHLA KELLEZI
DADMA E NOTEREVE
TIRANE

[Signature]





V E N D I M

NR. 1, DATE 06.10.1999

Ortaku i Vetem i shoqerise tregtare "JOY TRAVEL" sh.p.k, duke pare ecurine e shoqerise dhe mundesite e saj, ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe statutit te shoqerise :

V E N D O S I :

1. Ortaku i vetem i shoqerise, zj.Xhoana Nano transferon pjeserisht kuota te kapitalit qe zoteron, si me poshte :

Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

2. Futjen ne shoqeri te ortakeve te rinj duke aritur ne kete menyre pjesmarja ne kapital :

Xhoana Noano	70 %	ose	70'000 leke
Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke
T o t a l i	100 %	ose	100'000 leke

3. Per aresye te kalimit te shoqerise nga ortak i vetem me disa ortake miratohen edhe disa ndryshime ne statutin e shoqerise :

Fraza "Ortaku i Vetem" zevendesohet me "Asamblea e Ortakeve"

Neni 6 behet

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100'000 leke dhe perbehet nga 100 kuota nga 1000 leke secila me kontributet e ortakeve si me poshte:

Xhoana Noano	70 %	ose	70'000 leke
Besim Kaca	5 %	ose	5'000 leke
Astrit Hoxha	15 %	ose	15'000 leke
Koco Gaba	5 %	ose	5'000 leke
Nesti Decka	5 %	ose	5'000 leke

T o t a l i

100 %

ose

100'000 leke

Te gjithë kuotat e kapitalit themeltar janë te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtësisht. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

Shtohet neni 6/1

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

Shtohet neni 6/2

Ortakët mund t'u shesin te tretteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi tua kene ofruar per blerje ortakeve brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te tretteve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakeve te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

Shtohet neni 10/1

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.

Neni 11 behet

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Asambleja e Ortakeve
- Administratori

